



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 397/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat kryesues, Nenad Lazić, dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Fushë Kosovë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Fushë Kosovë, për shkak të vendosjes së posterit në objekte publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 04.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Fushë Kosovë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 30.10.2013, nga subjekti politik LVV dega në Fushë Kosovë, me të cilën pretendohet se më 29.10.2013 në ora 12:15 aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje kanë vërejtur posterin e Partisë Demokratike që ishte ngjitur në shtyllën e ndriçimit rrugor në Rr. Nëna Terezë. Parashtruesi i ankesës thekson se vendi ku është ngjitur posterit është në pronësi publike të komunës, ngjitja e materialit zgjedhor është në kundërshtim me dispozitat ligjore që janë në fuqi dhe posterit i ngjitur është i kandidatit për Kryetar të Komunës. Sipas parashtruesit të ankesës është bërë shkelje e Nenit 33 pika b) të LZP-së, dhe nenit 3.4 pika b të Rregullës Zgjedhore Nr. 11/2013. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur disa fotografi si dëshmi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore se posteret e kandidatit për kryetar të komunës të subjektit politik PDK janë vendosur në pronësi publike, nuk qëndrojnë sepse nuk është ofruar dëshmi bindëse për të vërtetuar se ku gjendet shtylla në fjalë dhe se a është në pronësi publike të komunës, me këtë rast vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar dhe nuk mund të vërtetohet shkelja e supozuar. Andaj në kuptim 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur PZAP-i vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 397/2013 më datën 04.11.2013

Kryesuesi i Panelit
Nehat Idrizi



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*